



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 29/11
Prishtinë, më 29.09.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Hasime Krasniqi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexander Beetz, Rihane Zylfiu dhe Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtur e komisionit, datë 21.09.2011;**
- 3. Miratimi i propozim amandamentit të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-45 për Partneritet Publiko Privat;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-41 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 7. Miratimi i propozim amandamentit të grupit punues për Projektligjin nr.04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike;**
- 8. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më datën 21.09.2011

Procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Miratimi i propozim-amendamentit të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-45 për Partneritet Publiko-Privat

Kryetarja, pasi që për amendamentin 5 të projektligjit për PPP-së, komisioni kishte shtyer për votim, me qëllim të konsultimeve shtesë, dhe pas konsultimeve janë bërë tri ndryshime, që janë propozuar si amendamente. Njëri amendament ka të bëjë me ndryshimin e emrit të Komisionit Drejtues Ndër-Ministror për Partneritete Publiko-Privat në Komitet për Partneritetet Publiko-Privat. Është futur një amendament me të cilin Komiteti shqyrton projekte që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale, atëherë një përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës ka të drejtë të merr pjesë në mbledhje në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote si dhe një amendament tjetër përmes së cilit Komiteti miraton projektet që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale në plotësohen këto tri kritere: projekti është në kuadër të kompetencave komunale të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komuna ka siguruar financimin adekuat për implementimin e projektit dhe komuna e ka siguruar një ndarje adekuate të rrezikut midis sektorit privat dhe atij publik.

Hykmete Bajrami, theksoi që edhe me këto amendamente nuk janë zgjidhur problemet që janë diskutuar në mbledhjen e kaluar, sepse përbërja e Komisionit për PPP ka mbetur e njëjtë, por ka ndryshuar vetëm emri, si dhe përfaqësuesi nga Asociacioni i Komunave ka të drejtë të merr pjesë vetëm në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote. Kjo tregon se janë bërë vetëm disa ndryshime kozmetike dhe kanë mbetur po të njëjtat probleme.

Naser Osmani, theksoi se meqenëse përfaqësuesi i komunës është aty dhe ka të drejtën e vetos në marrjen e vendimit lidhur me projektin e caktuar, atëherë kam rigjykuar mendimin se a ka nevojë të jetë përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave i cili nuk ka të drejtën e votës, pra mund edhe të mos jetë, sepse nuk qon peshë, pasi që nuk e ka të drejtën e votës.

Albana Fetoshi, kërkoi sqarime lidhur me të drejtën e vetos që e ka komuna, pasi që projektin e jep komuna, ndërsa vendimin e merr Ministri.

Robert Muharremi, sqaroi se sipas ligjit që është në fuqi komuna e paraqet projektin dhe vendimin e merr Komisioni Ndër-Ministror, do të thotë komuna nuk ka mundësi të sigurohet që Komisioni nuk do t'ia ndryshojë në tërësi projektin ose imponon kushte që nuk janë në kuadër të politikave ekonomike-sociale të autoriteteve komunale. Me qëllim që t'i sigurohet komunës që të mos i imponohen kushte të papërshtatshme nga Komisioni Ndër-Ministror, me këtë projektligj është rregulluar që komunës t'i jepet e drejta e vetos në vendimet e Komitetit, nëse komuna mendon që ky komitet po ia ndryshon projektin në dëm të interesit komunal.

Komisioni njëzëri miratoi amendamentin 2 me tekstin si në vijim:

Në tërë tekstin e projektligjit, fjala “Komisioni Drejtues Ndër-Ministror për Partneritete Publiko-Private” zëvendësohet me fjalën “**Komiteti për Partneritete Publiko-Private**”, si dhe në tërë tekstin e projektligjit shkurtesa “KDNM-PPP”, zëvendësohet me shkurtesën “**KPPP**”.

Komisioni me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi dhe Xhevdet Neziraj), një kundër (Muhamet Mustafa) dhe tri abstenime (Hykmete Bajrami, Albana Fetoshi dhe Sali Asllanaj) miratoi amendamentin 1, me të cilin ndryshohet paragrafi 3 i nenit 16 të projektligjit me tekstin si në vijim:

“3. Në rastet kur Komiteti për Partneritete Publiko-Private shqyrton projekte që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale, një përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka të drejtë që të merr pjesë në mbledhjen e Komitetit për Partneritete Publiko-Private, në cilësinë e vëzhguesit dhe pa të drejtë vote.”

Komisioni njëzëri, miratoi amendamenti 3 që i referohej nenit 22, paragrafit 4, me tekstin si në vijim:

“4. Në rast të shqyrtimit të projekteve që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale, Komiteti për Partneritete Publiko-Private miraton projektin nëse plotësohen kriteret si në vijim:

- (i) projekti është në kuadër të kompetencave komunale të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale,
- (ii) komuna e ka siguruar financimin adekuat për implementimin e projektit, dhe
- (iii) komuna e ka siguruar një ndarje adekuate të rrezikut midis sektorit privat dhe atij publik”.

Pas propozimeve Komisioni nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni me dhjetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa dhe Sali Asllanaj), asnjë kundër dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), miratoi raportin me amendamente për Projektligjin për Partneritete Publiko-Privat.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Kryetarja, theksoi që në raportin me amendamente të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së është neni 20, paragrafi 3 që mund të ketë implikime buxhetore që ka të bëjë me një përfitim prej 50% të pagës së rregullt mujore dhe atë vetëm një herë në vit. Është një agjencion specifik, është çështja e një departamenti që ka funksionuar në kuadër të Policisë së Kosovës dhe tani bartet si agjencion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nuk shkakton implikime buxhetore. Kryetarja propozoi që në nenin 9 të Projektligjit, që ka të bëjë me buxhetin të bëhen disa përmirësime e të ndryshohet si në vijim: “ Agjencioni Kosovar i Forenzikës e është zë i veçantë buxhetor në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Buxheti i AKF-së duhet të shqyrtohet dhe të miratohet në procesin e rregullt buxhetor në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.” Është e nevojshme që të definohet, në mënyrë që të mos shkaktohet konfuzitet, pasi që është një agjencion specifik.

Muhamet Mustafa, theksoi se nuk është logjike të ketë buxhetin e veçantë, pasi që është agjencion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe përgjigjet Ministri i Punëve të Brendshme.

Kryetarja, sqaroi se ky agjencion i përgjigjet Ministrisë, mirëpo personeli i kësaj agjencie është kategori më e veçantë dhe mund të përcaktohen beneficionet për punëtorët e kësaj agjencie, mos të krijohet përshtypja se mund të krijojnë brenda vitit dhe gjërat të jenë të planifikuara.

Pas propozimit, Komisioni me dhjetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Hykmete Bajrami, Muhamet Mustafa dhe Sali Asllanaj), asnjë kundër dhe një abstenim (Albana Fetoshi), miratoi amendamentin 1 të propozuar komisioni për riformulimin e nenit 9 të projektligjit.

Pas diskutimeve, komisioni njëzëri nxori

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Legjislacion

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-41 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Miratimi i propozim-amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike

Xhevdet Neziraj, theksoi që grupi punues ka punuar duke marrë për bazë sugjerimet e GIZ-it dhe të organizatave të tjera dhe ka analizuar duke nxjerrë si përfundim amendamentet të cilat do të miratohen në komision, përveç te amendamenti i 6 që janë dy propozime. Te amendamenti 3 propozoi që të bëhen disa përmirësime në formulim duke ndryshuar tekstin si në vijim: “10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet tjera politike jashtë parlamentare dhe jashtë asambleve komunale”.

Kryetarja, lidhur me amendamentin 1 theksoi që nuk ka ndonjë ndryshim të madh, më tepër është një ndryshim teknik që mund të harmonizohet dhe propozoi që të hiqet.

Komisioni njëzëri vendosi që amendamenti 1 të fshihet në tërësi, ndërsa njëzëri miratoi amendamentin 2, 3, 4 dhe 7.

Latif Gashi, lidhur me amendamentin 3 sqaroi se vet fjala “subjektet tjera politike” nënkupton ato parti politike që nuk janë futur në kuadër të Parlamentit.

Albana Fetoshi, propozoi që fjala “për zgjedhjet përkatëse” të fshihet, sepse kjo po nënkupton që subjektet janë regjistruar tani për zgjedhjet përkatëse dhe nuk po i përfshin ato që janë regjistruar më herët. Partitë politike certifikohen për çdo zgjedhje, mirëpo nuk regjistrohen për çdo zgjedhje.

Latif Gashi, sqaroi se propozimi i znj. Fetoshi ka të bëjë me një subjekt që është regjistruar dhe nuk dëshiron të garojnë dhe nuk certifikohet, mirëpo që mund të jetë pjesë e buxhetit dhe për këtë arsye është futur fjala “për zgjedhjet përkatëse”. Ndërsa kjo çështje që ka qenë kërkesë edhe e shumë deputetëve është rregulluar duke shtuar paragrafin e ri të nenit 5, i cili rregullon çështjen e mjeteve financiare për ato subjekte politike të cilat i marrin mjetet, por nuk garojnë në zgjedhje.

Naser Osmani, theksoi që fjala është për 10%-shin për ato parti politike që nuk fitojnë vend në Parlament. Gjithashtu propozoi që neni 6 dhe 8 i projektligjit të fshihet në tërësi, pasi që nuk ndodh që asnjë parti politike dhe asnjë institucion tjetër t’i japë raport Auditorit të Përgjithshëm, sepse kjo është një shtrembërim i asaj se si funksionon sistemi. Auditori i Përgjithshëm me ligj ka kompetencë që t’i kontrollojë të gjitha paratë publike duke përfshirë edhe partitë politike, mirëpo nuk duhet të jetë kështu i formuluar, por të mbetet ashtu siç ka qenë në ligjin e vjetër. KQZ-ja duhet të mbetet organ të cilit i raportohet dhe i cili i kontrollon partitë politike dhe në asnjë mënyrë Auditori i Përgjithshëm.

Latif Gashi, theksoi që vërejtjet e para të grupit punues kanë qenë në lidhje me raportimin, mirëpo lidhur me këtë çështje na kanë ndihmuar përfaqësues të GIZ-it, të cilët kanë bërë krahasime me vendet tjera evropiane dhe është vërejtur që pothuajse në të gjitha vendet subjektet politike i raportojnë Auditorit të Përgjithshëm. Gjithashtu ka qenë kërkesa edhe e Komisionit Evropian që të jetë transparenca më e madhe dhe të bëhet vetë disiplinimi i partive politike. Më tepër është çështje teknike dhe nuk e ndryshon procedurën e raportimit të deritanishme, përkundrazi e shton transparencën.

Muhamet Mustafa, theksoi që nuk duhet kuptuar që Auditori i Përgjithshëm është shëf i partive politike, mirëpo i dërgohet një kopje e raportit dhe kjo realizohet për hir të transparencës. Esenciale është se tani Auditori i Përgjithshëm i kontrollon të gjitha partitë veç e veç, për dallim nga e kaluara që i kontrollonte KQZ-ja. Kjo është një zgjidhje e dobishme dhe e ngjashme me disa vende tjera.

Naser Osmani, theksoi që kur të merren si model vendet tjera, atëherë duhet të merret parasysh se ato vende nuk e kanë të rregulluar çështjen e auditorit ashtu sikur e kemi në Kosovë, për shkak se ato i kanë gjykatat e kontrollit, prandaj nuk mund të merret kjo analogji dhe kjo nuk mund të funksionojë në Kosovë, sepse është çështje që lidhet drejtpërdrejtë me partitë politike. KQZ-ja i bën transparente të gjitha deklaratat financiare, mirëpo mund të kërkohet që KQZ-ja të bëjë transparente edhe gjendjen financiare të partive politike.

Xhevdet Neziraj, sqaroi që përgjegjës për pasqyrat financiare është kryetari i subjektit dhe personi përgjegjës i financave. Financimi është bërë nga Kuvendi dhe nga KQZ-ja, për arsye se partitë politike i raportojnë KQZ-së dhe Auditori i Përgjithshëm auditon secilin subjekt politik.

Kryetarja, theksoi që të gjitha partitë politike raportojnë edhe pse ekziston përshtypja që ato nuk raportojnë. Ndonjëherë nuk është problem ligji, por është problemi se si t’i fusim gjërat në sistem. Auditori e auditon KQZ-në, departamentin e partive politike dhe raportet e të gjitha partive politike.

Komisioni me tetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj), një kundër (Muhamet Mustafa) dhe dy abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi), vendosi që të fshihet neni 6 i projektligjit

Komisioni me dhjetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa dhe Sali Asllanaj), asnjë kundër dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), vendosi që të fshihet neni 8 i projektligjit.

Latif Gashi, theksoi se çështja e donacioneve ka qenë njëra prej mangësive të projektligjit dhe ka pasur vërejtje nga Komisioni Evropian se as nuk e ndalon e as nuk e rregullon në mënyrë të saktë çështjen e donacioneve. Grupi punues për këtë çështje ka bërë dy propozime, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit që të bëhet një zgjedhje në mes të këtyre dy propozimeve.

Hykmete Bajrami, theksoi se propozimi i parë është shumë i përgjithësuar dhe kjo nuk do ta ndalojë, sepse nuk ka mekanizëm që mund t'i kontrollojë ato.

Albana Fetoshi, propozoi që shuma e cekur në propozimin e dytë që është trefishi i pagës mesatare në Republikën e Kosovës duhet të jetë transparente me emër e mbiemër, pasi që këto mjete mund të vijnë donacion nga dikush dhe mos të dihet prejardhja.

Xhevdet Neziraj, theksoi se propozimin e dytë, që rregullon në mënyrë më të qartë problemin e financimit të subjekteve politike nga dhënia e donacioneve, që ka qenë edhe kërkesë nga raporti i progresit.

Muhamet Mustafa, theksoi që problemi qëndron te konflikti i interesit që mbi dhënien e donacioneve të sigurohen kontrata dhe nuk është e tepërt që të definohet edhe konflikti i interesit.

Naser Osmani, propozoi që të bëhet një kombinim në mes të dyja propozimeve, si në vijim: Ndalohet dhënia e donacioneve nga të cilat dhuruesi në mënyrë të qartë mund të përfitoj ndonjë avantazh ekonomik. Donacionet e personave fizik dhe juridik për subjekte politike duhet të bëhen në mënyrë transparente në llogari bankare dhe duhet të përfshihen në raportet financiare të subjekteve politike përfituese. Raporti financiar i subjekteve politike duhet të përmbajë emrin dhe numrin e regjistrimit për personat juridike apo emrin, mbiemrin dhe adresën për personat fizikë.

Kryetarja, sqaroi se po ndalohet që të ketë përfitim ekonomik nga donacioni që e jep dhe njëkohësisht po kërkohet që të bëhet transparente në raportin financiar shuma që e jep dhe të shënohen detajet e personit juridik dhe atij juridik. Shuma sa lejohet që të jepet është e paraparë në nenin 5 Kontributet për Subjektet Politike.

Komisioni njëzëri miratoi riformulimin e amendamentit 6.

Kryetarja, kërkoi sqarime pse është hequr kandidati për president në amendamentin 7.

Latif Gashi, sqaroi për amendamentin 7 lidhur me kandidatin për president është hequr, për shkak se ende nuk është ligji që e rregullon zgjedhjen e presidentit.

Xhevdet Neziraj, sqaroi se problemi qëndron te ligji për president, sepse duhet të dihen njëherë ndryshimet kushtetuese.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Miratohen propozim amendamentet e grupit punues me ndryshimet e bëra në komision. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

8. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit me bashkëpunëtoren e re që e ka përzgjedhur GIZ-i znj, Rejhane Zylfiu, e cila do të jetë në dispozicion për punët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona